



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 213, datë 31.3.2021

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.775, DATË 30.9.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT NGA BASHKIA Durrës, MIRATUAR
NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT
TË PROJEKTPREVENTIVIT DHE RIFORCIMIN E HIDROVORIT
TË Durrësit"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- I. Në vendimin nr.775, datë 30.9.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit".
 2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 88 128 502 (tetëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë pa TVSH, për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të

kullimit në zonën e Porto-Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, të detajuar, si më poshtë vijon:

- a) Për vitin 2020, në masën 51 550 000 (pesëdhjetë e një milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH;
- b) Për vitin 2021, në masën 36 578 502 (tridhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë pa TVSH.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit.”.

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHËTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1709/1
DATË 2. 4. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË DURRËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAJ

